

MUHARREM DEZHGIU

**PROBLEME HISTORIOGRAFIKE NË VEPRËN E ALI HADRIT
PËR LUFTËN E DYTË BOTËRORE NË SHQIPËRI***

Akademik Ali Hadri bën pjesë në plejadën e historianëve shqiptarë të Kosovës, të cilët patën si objekt studimi një tematikë të gjerë të historisë së popullit shqiptar.

Ai ka meritën se problemet historiografike i shikon si një proces unik në të gjithë veprimtarinë e punës së historianit. Për akademik Ali Hadri, në rolin e studiuesit të historisë, ka peshën e vet si monografia, ashtu dhe artikulli shkencor, si kritika shkencore, ashtu edhe teksti mësimor. Në pasurinë historiografike të këtij studiuesi janë të pranishme pothuajse të gjitha zërat e veprimtarisë shkencore. Mbi 100 zëra të tillë të veprimtarisë prodhuese shkencore të Ali Hadrit janë pasqyruar në manualët bibliografike të punimeve historike, të publikuara në Kosovë¹.

Në fokusin e punimeve të tij rroken pothuajse të gjitha periudhat historike të historisë së shqiptarëve. Në mënyrë të natyrshme, vendin zotërues në tematikën e studimeve të akademik Ali Hadrit, e ka zënë problematike që lidhet drejtpërdrejt me historinë e trevës së Kosovës. Por, ai nuk la jashtë vëmendjes dhe problemet historiografike që kishin objekt historinë mbarëshqiptare. Në kuadër të kësaj tematike studimore, Ali Hadri bëri objekt trajtimi tema e probleme historiografike për Luftën e Dytë Botërore në Shqipëri. Kjo çështje do të përbëjë dhe objektin e kësaj kumtese.

Për hulumtimin e kësaj teme jam mbështetur në shkrimet e tij të botuara në revistat shkencore, në kritikën shkencore që ai i ka bërë

* Kumtesë e përgatitur në dhjetor 2007, me rastin e veprimtarisë kushtuar jetës dhe veprës së prof. Ali Hadrit.

¹ D. Bislimi, *Bibliografi e punimeve historike të publikuara në Kosovë gjatë viteve 1946-1989*, Prishtinë, 2006, f. 83-95.

historiografisë jugosllave, si dhe në tekstet mësimore ku ka zënë vend dhe historia e Luftës së Dytë Botërore.

Në tekstet mësimore të hartuara prej tij, kanë gjetur pasqyrim pothuajse të gjitha ngjarjet kryesore historike të popullit shqiptar në vitet e Luftës së Dytë Botërore, të karakterit politik, organizativ, ushtarak e shpirtëror të kësaj lufte, që nga pushtimi i Shqipërisë dhe deri në çlirimin e saj.

Në veprën studimore të tij dallohet mjaft qartë përpjekja për bashkimin e objektivitetit shkencor me qëndrimin atdhetar kombëtar. Kjo duket më qartë në kritikën historiografike të Ali Hadrit. Ai nuk mund të qëndronte duarkryq, kur popullit të tij i mohohej apo i shtrembërohej identiteti dhe historia, kur “i grabiteshin” heronjtë kombëtarë dhe personalitetet e kulturës². Në mënyrë të natyrshme ai ishte kundër pasaktësive të ngjarjeve historike, të cilat lidhen me pozitën e Shqipërisë dhe të shqiptarëve gjatë Luftës së Dytë Botërore. Duke kritikuar punimin “Historia e Jugosllavisë”, gjen rastin të saktësojë se “Shqipëria u pushtua nga ana e Italisë qysh në prill të vitit 1939” dhe nuk bëhej fjalë “për një farë protektorati”³.

Gjithashtu ai hedh poshtë si të gabuar pikëpamjen se “Lufta Nacionalçlirimtare merr hov të madh në Shqipëri vetëm në kohën e betejës në Neretvë dhe në Sutjeskë”. Sipas tij, “Lëvizja Nacionalçlirimtare dhe lufta e armatosur në Shqipëri kishin përpjesëtime të gjera qysh në vitin 1942”⁴. Ndonëse ky pohim bëhej duke u nisur nga një pozicion i caktuar politik, është shumë më i saktë nga vlerësimi që i bënte historiografia jugosllave rolit të Lëvizjes Nacionalçlirimtare dhe luftës së armatosur në Shqipëri.

Një vend të rëndësishëm kanë zënë në veprën e A.Hadrit problemet historiografike që lidhen me krijimin e PKSh dhe të forcave të tjera politike, me rolin e të huajve në procesin e kësaj lufte, me bashkëpunimin e Lëvizjeve Nacionalçlirimtare të Shqipërisë dhe të Jugosllavisë, me qëndrimin e forcave politike ndaj njëra-tjetrës, me ngjarje historike si Mbledhja e Mukjes, Konferenca e Bujanit etj.

² A. Hadri, *Kritikë historiografike*, Shkup, 1973, f.84-85.

³ *Po kreti otpora u Evropi*, 1968, f.17-19. Sipas Ali Hadri, *vep. e për.*, f. 85.

⁴ *Po aty*, f.87.

Për çështjen e krijimit të PKSh mban qëndrim kritik kundrejt versioneve të kujtimeve të V.Tempos⁵, sipas të cilave, krijimin e PKSh ia atribuon rolit të deleguarve të PKJ. Ndërsa Ali Hadri shprehet se “krijimi i PKSh është vepër e vetë komunistëve shqiptarë”. Për një pohim të tillë ai mbështetet, siç thotë vetë ai, në “botëkuptimin marksist-leninist, lidhur me raportin midis faktorëve të brendshëm dhe të jashtëm”⁶.

Faktet që sjell Ali Hadri për rrethanat e brendshme e të jashtme, në të cilat u krijuar PKSh, anojnë te faktorët e jashtëm (kujto këtu direktivën e korrikut 1941 të KQ të PKJ, për Komitetin Krahinor të PKJ për Kosovë-Metohi për të biseduar me komunistët e Shqipërisë, nisur nga nevojat e rrethanat pas sulmit të Gjermanisë kundër BS etj.⁷).

Duket se për këtë çështje, është pozicionuar në krah të pikëpamjes historiografike shqiptare të kohës. Më tej ai shton se “mendimi i S.V. Tempos, që delegatët e PKJ, Miladin Popoviç dhe Dushan Mugosha janë themelues të PKSh, është i papranishëm nga historiografia marksiste”⁸.

Në kritikën që bëri në adresë të V. Tempos lidhur me vijën politike të PKSh, për strategjinë dhe taktikën e saj në qëndrimin ndaj Ballit Kombëtar, Ali Hadri mbështetet në pohimet e historiografisë shqiptare, të natyrës klasore e ideologjike. Duke pasur për bazë vlerësime kategorike të natyrës propagandistike, pohonte se, “që në nëntor të vitit 1941 PKSh kishte një program politik të qartë që i përgjigjej çastit historik, kërkesave të popullit dhe nevojës së domosdoshme të organizimit dhe të ngadhënjimit të LNÇ dhe të revolucionit popullor”⁹. Duke u mbështetur në një “aksiomë” të tillë, ai do të konsideronte si të pavërteta pohimet e V.Tempos që, PKSh orientonte që, me çdo kusht, të lidhej marrëveshja me lëvizjen balliste”, që “PKSh nuk kishte formuar njësitë e mëdha ushtarake, për të mos penguar marrëveshjen me Ballin Kombëtar, që “Marrëveshja që lidhi Ymer Dishnica me Ballin Kombëtar në Mukje, është zbatimi i vijës së KQ të PKSh në lidhje me këtë çështje”¹⁰.

Burimet dokumentare që dëshmojnë vërtetësinë e pohimeve të mësipërme janë të pamohueshme. Vija e bashkëpunimit midis forcave

⁵ S.V. Tempo, *Revolucija koja teče*, Beograd, 1980, f. 334.

⁶ A. Hadri, *vep. e për.*, f.93.

⁷ AEHK, d. 358. Cituar sipas A.Hadrit, *vep. e për.*, f.96-97.

⁸ A. Hadri, *vep. e për.*, f.98.

⁹ *Po aty*, f.109.

¹⁰ S.V. Tempo, *vep. e për.*, f. 365-367. Cituar sipas A.Hadrit, *vep. e për.*, f.101.

politike shqiptare gjatë luftës, deri në Mbledhjen e Mukjes (gusht 1943) ishte pjesë përbërëse e programit politike, si të PKSh dhe të Ballit Kombëtar. Përpyekjet e historiografisë shqiptare, përfshi dhe atë të akademik Ali Hadrit, për ta mohuar këtë vijë politike, janë bërë thjesht nga pozita politike mbrojtëse ndaj akuzave të V. Tempos.

Kritika ndaj V. Tempos mund të bëhet në drejtimin se ai nxiste PKSh që, në qëndrimin e saj ndaj Ballit Kombëtar, ta shtynte në rrugën e konfrontimit sa më të shpejtë me të, sepse vetëm kështu realizonte përçarjen e shqiptarëve politikisht.

Në fund të fundit, ku çonte “akuza” që bënte Tempo, sipas së cilës, “PKSh ka vënë në qendër të aktivitetit të saj lidhjen e marrëveshjes me Ballin Kombëtar”¹¹? Marrëveshja me Ballin Kombëtar ishte arritur dhe përbënte një sukses të forcave politike, e cila u mbështet plotësisht nga shqiptarët. Kjo marrëveshje nuk i interesonte të deleguarit të PKJ pranë PKSh, prandaj urdhëruan që të mos pranohej nga udhëheqja e PKSh.

Në mungesë të dokumenteve, për të trajtuar ngjarje të ndryshme të kësaj lufte, Ali Hadri bie në pozitën e trajtimit të njëanshëm e të politizuar të tyre. Diku do të shprehet: “Dihet *me siguri* se Ymer Dishnica nuk u përmbahet direktivave të KQ të PKSH dhe, si rrjedhim, ishte përjashtimi i tij nga udhëheqja e Partisë dhe mospranimi i kësaj marrëveshjeje nga organi më i lartë partiak”¹².

Ali Hadri nuk kishte në dorë dokumentacionin arkivor të kohës, të publikuar më vonë, si korrespondencën e Ymer Dishnicës me E. Hoxhën apo procesverbalin e Plenimit II të KQ të PKSH të nëntorit 1944, mbi të cilat mbështetet pasqyrimi i së vërtetës historike mbi Mbledhjen e Mukjes dhe marrëveshja historike e arritur në të nga forcat politike shqiptare.

Ali Hadri ka mbajtur një qëndrim të prerë intransigjent ndaj Ballit Kombëtar, i inspiruar dhe i ndikuar nga politika dhe ideologjia e forcës në pushtet. Prandaj përçonte pikëpamjen se “nuk mund të pranohet mendimi se ballistët “kanë bashkëpunuar fiktivisht”, me pjesëtarët e LNÇ në Shqipëri”¹³. Tregonte siguri, kur pohonte se, parimet programatike të Ballit Kombëtar, nuk mund të karakterizohen si “relativisht përparimtare” (siç shprehet Branko Boshkoviç), porse janë demagogjike dhe të

¹¹ A. Hadri, *vep. e përm.*

¹² Autori i referohet Xh. Frashërit në Konferencën e Studimeve Shoqërore, nëntor 1969.

¹³ A. Hadri, *vep. e përm.*, f. 154.

formuluara ashtu sa që t'i mashtrojnë masat”¹⁴. Për të, Balli Kombëtar “ishte organizatë reaksionare, sepse mbronte interesat e borgjezisë reaksionare, të pronarëve të mëdhenj”, se “Komitetin e kësaj organizate e përbënin reaksionarët e shquem”¹⁵. (A ishte i tillë Mit'hat Frashëri?)

Metodologjia dhe terminologjia e përdorur nga akademik Ali Hadri mbi problemet historiografike për Luftën e Dytë Botërore në Shqipëri, përcaktohen nga ngarkesa politike e kohës, kur ai ka shkruar. Tani, pas dy dekadash nga shqyrtimi i veprës së Ali Hadrit, vetëkuptohet më qartë se qëndrimi i mjaft intelektualëve ishte një përshtatje e detyruar, një bashkëjetesë me sistemin e kohës. Guximi për ta thënë të vërtetën historike, sidomos, në kushtet e Kosovës nën pushtim, përbënte një sakrificë të madhe për intelektualët, sepse do të pasohej me privacione të rënda.

Mbrojtësit e vendosur të së vërtetës historike me siguri do të bënin pjesë në radhët e martirëve të çështjes kombëtare shqiptare, të cilët u etiketuan si kundërrevolucionarë, reaksionarë, ballistë shqiptaromëdhenj etj.

Sigurisht, ky trajtim i historisë në përshtatje me rrethanat politike të kohës, përbën një kufizim të studiuesit në metodologjinë e tij për të shkruar drejt së vërtetës. Vepra e Ali Hadrit përbën një arritje të domosdoshme të shkencës historiografike shqiptare, të mundshme për atë kohë. Në kushtet e sotme, kërkohet të mbahet një qëndrim rivlerësues ndaj saj, për të pasqyruar jashtë kornizave e shablloneve metodologjike e ideologjike të gjithë problematikën historiografike të periudhës së Luftës së Dytë Botërore. Daljen jashtë këtyre vargonjve e kërkonte edhe Ali Hadri, sepse i konsideronte pengesa të mëdha për të shprehur të vërtetën.

Këtë bindje e mbështes në faktin se ai, me formimin solid si historian e atdhetar, ka përdorur nëntekstin në shkrimet e tij, si një mënyrë për t'i shpëtuar censurës politike. Me këtë stil të shkruari, ai i jepte lexuesit të kuptonte atë ide që kishte dashur të përçonte, në rrethanat e lirisë akademike¹⁶.

Vepra e akademik Ali Hadrit dhe e bashkëkohësve të tij, pa dyshim, përfaqëson një etapë tepër të rëndësishme të zhvillimit të historiografisë

¹⁴ B. Brankoviç, *Lëvizja NÇ në Basenin e Ibrit*, 1968, f. ... (punim i marrë në shqyrtim për kritikë nga A. Hadri, f. 154).

¹⁵ A. Hadri, *Pasqyrë e historisë së shqiptarëve*. Për nxënësit e shkollave të mesme, Beograd, 1967, f. 126.

¹⁶ Po ai, *Kritikë ...*, f. 216.

në Kosovë. Ajo përbën themel për të punuar më tej në shtetin e lirë e të pavarur të Kosovës.